

Indeksi i Kushtimit në Ndërtim (për Banesa)

Metadata Referenciale në format Euro SDMX Metadata Structure
(ESMS)

INSTAT

Metadata Referenciale

1. Kontakt.....	2
2. Përditësimi i metadatave	2
3. Paraqitja statistikore	2
4. Njësia matëse	4
5. Periudha e referencës	4
6. Mandati institucional	4
7. Konfidencialiteti	4
8. Politika e botimit.....	5
9. Shpeshhtësia e shpërndarjes.....	6
10. Aksesimi në të dhëna dhe qartësia	6
11. Manaxhimi i cilësisë	7
12. Rëndësia.....	7
13. Saktësia dhe besueshmëria.....	8
14. Afatet kohore dhe përpikmëria	9
15. Koherenca dhe Krahueshmëria.....	9
16. Kostoja dhe ngarkesa	10
17. Rishikimi i të dhënave	10
18. Përpunimi statistikor	10
19. Komente.....	11
Aneks	11

1. Kontakt	
1.1. Institucioni i kontaktit	INSTAT, Instituti i Statistikave
1.2. Njësia e kontaktit	Sektori i Çmimeve, Drejtoria e Statistikave të Sektorit Real
1.3. Personi i kontaktit	Rovena Gjyshi
1.4. Funkzioni i personit të kontaktit	Specialiste në Sektorin e Çmimeve
1.5. Adresa postare	Rr. Vllazën Huta, Ndërtesa 35, Hyrja 1, Tiranë, Shqipëri, Kodi Postar 1017
1.6. Adresa elektronike (e-mail)	rgjyshi@instat.gov.al
1.7. Numri i telefonit	+(355) 4 2222411 / +(355) 4 2233356
1.8. Numri i faksit	+(355) 4 2228300
2. Përditësimi i metadatave	
2.1. Çertifikimi i fundit i metadatës	04.03.2021
2.2. Publikimi i fundit i metadatës	04.03.2020
2.3. Përditësimi i fundit i metadatës	04.03.2021
3. Paraqitja statistikore	
3.1. Përshkrimi i të dhënave	Indeksi i Kushtimit në Ndërtim për banesa (IKN për banesa) mat ecurinë e çmimeve të faktorëve të prodhimit, lëndëve të para, punës, makinerisë, transportit, energjisë dhe kostove të tjera që përdoren në projektet e ndërtimit. Të dhënat paraqiten në formë indeksi dhe ndryshime në përqindje (tremujore, vjetore). Indeksi i Kushtimit në Ndërtim (për banesa) mat ndryshimin në kostot e ndërtimit të periudhës korente krahasuar me periudhën bazë. Për llogaritjen e IKN (për banesa) krahasohen çmimet e materialeve të përdorura për ndërtim, kostot e orëve të punës të punonjësve

	në ndërtim, kostot operationale dhe të mirëmbajtjes të makinerive dhe kostot e pajisjeve mekanike.
3.2. Sistemi i klasifikimit	Klasifikimi i përdorur për këto statistika është Klasifikimi Statistikor i Aktiviteteve Ekonomike (NVE Rev.2). Shpenzimet janë klasifikuar në përputhje me klasifikimin që përdor EUROSTAT për Indeksin e Kushtimit në Ndërtim, në gjashtë grupe kryesore si më poshtë: · Materiale ndërtimi · Shpenzime për paga · Shpenzime për makineri · Shpenzime transporti · Shpenzime për energji · Shpenzime të tjera.
3.3. Mbulimi i sektorit	Indeksi i Kushtimit në Ndërtim përfshin aktivitetin e seksionit F: “Ndërtim” (kodet 41, 42, 43) dhe aktivitetet e Tregtisë me Shumicë të materialeve të ndërtimit: (kodet 46.73, 46.74, 47.52) sipas Nomenklaturës së Veprimtarive Ekonomike, Rev.2.
3.4. Koncepte statistikore dhe përkufizime	Indeksi i Kushtimit në Ndërtim (për Banesat) mat ecurinë e çmimeve të: materialeve të ndërtimit, kostos së punës, makinerisë, transportit, energjisë dhe kostove të tjera që përdoren në ndërtimin e një banese tipike (8-10 kate). Indeksi i shpenzimeve materiale mat ecurinë e çmimeve të materialeve kryesore të ndërtimit. Ky grup përbëhet nga tre nëngrupe: · Materialet e ndërtimit · Materialet elektrike dhe të komunikimit · Materialet hidro-sanitare. Indeksi i kostove të punës mat ecurinë e fondit të pagave për inxhinierët, teknikët dhe punëtorët.
3.5. Njësia statistikore	Njësitë statistikore për IKN janë ndërmarrjet sipas Regjistrit Statistikor të Ndërmarrjeve që kanë si aktivitet të tyre shitjen me shumicë të materialeve të ndërtimit dhe kompanitë e ndërtimit.
3.6. Popullata statistikore	Popullata statistikore përfshin të gjithë ndërmarrjet aktive në Regjistrin Statistikor të Ndërmarrjeve dhe klasifikohen në aktivitetin Ndërtim dhe Tregti materiale ndërtimi.
3.7. Zona e referencës	Të dhënat e IKN mbulojnë të gjithë territorin e vendit.

3.8. Mbulimi në kohë	Seria kohore e të dhënave të IKN (për banesa) është nga viti 1993.
3.9. Periudha bazë	Periudha bazë për të dhënat e IKN (për banesa) është viti 2011.
4. Njësia matëse	Njësitet e matjes janë: · Indekset · Ndryshim në përqindje (tremujor dhe vjetor).
5. Periudha e referencës	Të dhënat e mbledhura nga IKN (për banesa) janë tremujore. Ky raport i përket vitit referencë 2020.
6. Mandati institucional	
6.1. Akte ligjore dhe marrëveshje të tjera	IKN është pjesë përbërëse e rregullores mbi “Statistikat afatshkurtra”, si e tillë baza ligjore është e njëjtë. • Ligji Nr.17/2018 “Për Statistikat Zyrtare” • Programi Kombëtar i Statistikave Zyrtare, 2017-2021 • Rregullorja e Këshillit Evropian Nr. 1165/98 për Statistikat Afatshkurtra • Rregullorja e Komisionit Evropian Nr.1503/2006 për Statistikat Afatshkurtra.
6.2. Shkëmbimi i të dhënave	IKN dërgohet në EUROSTAT. Aktualisht INSTAT plotëson një sërë pyetësorësh të organizmave ndërkombëtare në lidhje me Indeksin e Kushtimit në Ndërtim për banesa, si Komisioni Evropian, Enterprise and Industry Directorate-General, OECD, etj.
7. Konfidencialiteti	
7.1. Konfidencialiteti - politika	Të dhënat e mbledhura nga ndërmarrjet konsiderohen si rreptësisht konfidenciale dhe përdoren vetëm për qëllime statistikore e kërkime shkencore në përputhje me Ligjin Nr. 17/2018, "Për Statistikat Zyrtare", i ndryshuar, si dhe Ligjin Nr. 9887, datë 10.03.2008 "Mbrotja e të Dhënave Personale". Neni 31 i ligjit “Për statistikat zyrtare” përcakton qartë që i gjithë informacioni statistikor i mbledhur nga INSTAT është konfidencial dhe mund të përdoret ose botohet vetëm në tabela përmbledhëse të tilla që nuk identifikojnë njësinë burim të informacionit. Identifikim i drejtpërdrejtë quhet kur një njësi statistikore identifikohet drejtpërdrejt nga emri, adresa ose ndonjë numër identifikimi i njohur zyrtarisht. Kur përpunimi i të dhënave kryhet në mënyrë të tillë që mundëson identifikimin

	e subjektit të të dhënave, të dhënat duhet të kodohen menjëherë, në mënyrë që subjektet të mos jenë më të identifikueshëm.
7.2. Konfidencialiteti - trajtimi i të dhënave	Instituti i Statistikave të Shqipërisë mbron dhe nuk shpërndan të dhënat e grumbulluara ose tek të cilat ka akses, që mundësojnë identifikimin direkt ose indirekt të njësive statistikore. Instituti i Statistikave merr të gjitha masat parandaluese në mënyrë që të bëjë të pamundur identifikimin e njësive të veçanta statistikore me mjete teknike ose mjete të tjera, që në mënyrë të arsyeshme mund të përdoren nga një palë e tretë. Të dhënat statistikore që mund të bëjnë të mundur identifikimin e njësisë statistikore shpërndahen nga Instituti i Statistikave nëse dhe vetëm nëse: a) këto të dhëna janë trajtuar, ashtu siç është përcaktuar në mënyrë të veçantë në Rregulloren, në mënyrë të tillë që shpërndarja e tyre nuk paragjykon konfidencialitetin statistikor ose b) njësia statistikore ka dhënë pëlqimin e saj, pa asnjë rezervë, për zbulimin e të dhënave. Të dhënat konfidenciale që i transmetohen Institutit të Statistikave përdoren vetëm për qëllime statistikore dhe personat e vetëm që kanë të drejtë të kenë akses në këto të dhëna janë personeli i angazhuar në këtë detyrë. Çështjet që i referohen respektimit të konfidencialitetit statistikor shqyrtohen nga stafi i Institutit të Statistikave. Është përgjegjësi e këtij stafi të sigurojë sa mëposhtë: Nivelin e detajimit në të cilën të dhënat statistikore mund të shpërndahen, në mënyrë që identifikimi, qoftë drejtpërdrejt ose tërthorazi, i njësisë statistikore të anketuar nuk është i mundur; kriterin e anonimatit për të dhënat në nivel mikro të ofruara për përdoruesit; dhënia akses tek të dhënat konfidenciale për studiuesit për qëllime shkencore.
8. Politika e botimit	
8.1. Kalendari i publikimeve	Njoftimet në lidhje me shpërndarjen e statistikave janë botuar në kalendarin e publikimit, i cili është në dispozicion në faqen e internetit. Njoftime dhe vonesat janë para-njoftuar në këtë kalendar. Në rastin e vonesave specifikohet data e publikimit të ardhshëm si dhe shpjegimi lidhur me arsyet e vonesave.
8.2. Aksesit në kalendarin e publikimeve	Kalendari i publikimeve është i aksesueshëm në faqen e internetit të INSTAT.
8.3. Aksesit i përdoruesve	Në përputhje me nenin 34 të Ligjit Nr 17/2018 “Për Statistikat Zyrtare”, statistikatat zyrtare shpërndahen në mënyrë që të gjithë përdoruesit të kenë të drejtë të menjëhershme dhe të barabartë, përdoren të gjitha format e mundshme të medias, INSTAT-i dhe agjencitë statistikore, duke pasur në

	program përgjegjësitë për shpërndarjen, kërkojnë të përmbushin çdo kërkesë të çdo organizate ose individi, për të dhëna të pabotuara ose analiza të veçanta. Kanalet nga të cilat përdoruesit mund të marrin rezultatet e publikimit janë si më poshtë: 1. Website – online release; 2. Kërkesat e shkruara; 3. Publikimi; 4. Kërkesa për të dhëna, seksioni për përdoruesit e jashtëm.
9. Shpeshtësia e shpërndarjes	Shpeshtësia e shpërndarjes të të dhënave të IKN (për banesa) është çdo tremujor.
10. Aksesimi në të dhëna dhe qartësia	
10.1. Njoftim për media	Sipas Kalendarit të publikimeve, çdo tremujor publikohet njoftim për media mbi Indeksin e Kushtimit në Ndërtim (për Banesa). Format i njoftimit për shtyp është përcaktuar nga sektori i publikimit. Data e publikimit vendoset në bashkëpunim me sektorin prodhues të treguesit. Njoftimi për shtyp i IKN (për Banesa) publikohet online në faqen e internetit të INSTAT.
10.2. Publikime	Të gjitha të dhënat për IKN (për banesa), përdoruesit mund ti gjejnë në faqen e internetit të INSTAT: • Indeksi i Kushtimit në Ndërtim • Vjetari Statistikor.
10.3. Baza e të dhënave on-line	Të gjitha informacionet vihen në dispozicion në dy gjuhë: Shqip dhe Anglisht. Që nga viti 2011, përmes sistemit Pc-Axis, për përdoruesit e jashtëm në faqen e internetit, bazën e të dhënave e aksesoni në linkun më poshtë: Databaza Statistikore .
10.4. Aksesimi në të dhënat mikro	Të dhënat e IKN (për banesa) nuk bëhen të disponueshme në nivel mikro, si pasojë e ruajtjes së konfidencialitetit. Të dhënat e agreguara, janë lloji i vetëm i të dhënave që ofrohet për përdoruesit e jashtëm. Edhe pse të dhënat mikro nuk publikohen, ato mund të aksesohen në bazë të nenit 31, pika 7 ligji nr 17/2018, "Për statistikën zyrtare".
10.5. Të tjera	Përdoruesit mund të dërgojnë kërkesa të tjera specifike nëpërmjet një sesioni të dedikuar për kontaktet në linku më poshtë: Kërkesë të dhënash .

10.6. Dokumentimi i metodologjisë	Një shpjegim i shkurtër lidhur me përkufizimet, konceptet kryesore dhe shpjegimet metodologjike për përdoruesit publikohet në njoftimin për shtyp dhe publikimet. Informacione shtesë u jepen përdoruesve të brendshëm kur është e nevojshme. Në faqen e INSTAT ka një seksion lidhur me metodogjinë mbi Indeksi i Kushtimit në Ndërtim për Banesat.
10.7. Dokumentimi i cilësisë	Sektori i Çmimeve dokumenton të gjithë procesin e punës dhe procedurat e Indeksit të Kushtimit në Ndërtim për qëllime të brendshme.
11. Manaxhimi i cilësisë	
11.1. Sigurimi i cilësisë	INSTAT është i angazhuar për sigurimin e cilësisë në prodhimin e statistikave zyrtare. Duke u bazuar në ligjin “Për statistikave zyrtare”, Nr. 17/2018, INSTAT përdor metoda dhe procese statistikore në përputhje me parimet dhe standardet shkencore të pranuar ndërkombëtarisht, si dhe kryen analiza të vazhdueshme, me qëllim përmirësimin e cilësisë dhe ofrimin e statistikave të përditësuara. Në kryerjen e detyrave të tij, INSTAT ndjek parimet e përgjithshme të menaxhimit të cilësisë, në përputhje me Kodin e Praktikës së Statistikave Evropiane (European Statistics Code of Practice). INSTAT për sigurimin e cilësisë udhëhiqet nga parimet e mëposhtme: paanshmëria, cilësia e proceseve dhe produkteve statistikore, orientimi për përdoruesit, orientimi për punonjësit, efektiviteti i proceseve statistikore dhe reduktimi i ngarkesës së të intervistuarve. Kontrollat e cilësisë dhe vlerësimi i të dhënave janë veprime që kryhen përgjatë tërë procesit dhe më pas analizohen nga stafi me qëllim përmirësimin e cilësisë së statistikave. Stafi ka përvojën e duhur për përlogaritjen e indeksit dhe i përfshirë në faza të ndryshme të përpilimit të tij, të tilla si: mbledhja e të dhënave, kontrollat fillestare, hedhja e të dhënave dhe kontrollat përfundimtare.
11.2. Vlerësimi i cilësisë	Sektori kontrollon çmimet çdo tre muaj. Nëse vërehet ndonjë çmim që ka lëvizje të madhe krahasuar me tremujorin e mëparshëm komunikohet me anketuesin. Nëse marrim një shpjegim justifikues për këtë ndryshim, çmimi përfshihet në llogaritje. Përndryshe anketuesi duhet të verifikojë përsëri çmimin e mbledhur në terren.
12. Rëndësia	
12.1. Nevojat e përdoruesit	Përdoruesit e IKN (për banesa) ndahen në përdorues të brendshëm dhe të jashtëm. Me përdorues të jashtëm nënkuptojmë:

	• Ministritë dhe administratat publike që i përdor këto të dhëna për qëllime të planifikimit të politikave ekonomike dhe sociale; • Universitete (professor/studentë të diplomuar), organizata kërkimore; • Organizatat jo fitimprurëse kombëtare dhe ndërkombëtare; • Bizneset; • Kërkues, student edhe të tjerë grupe të ngjashme. Me përdorues të brendshëm nënkuptohen sektorë të tjerë brenda INSTAT të cilët përdorin rezultatet e IKN (për banesa) si input në punën e tyre. Këto janë: • Drejtoria e Llogarive Kombëtare; • Sektori i Statistikve Afatshkurtra.
12.2. Kënaqësia e përdoruesit	Klikimet (Page Views) në lidhje me Indeksin e Kushtimit në Ndërtim për vitin 2020 janë rreth 19,650 klikime. Gjatë 2020 INSTAT ka kryer vërtetimin për matjen e kënaqësisë së përdoruesve nga publikimet e INSTAT. Rezultatet e vërtetimit tregojnë se cilësia e përgjithshme të statistikave të Indeksit të Kushtimit në Ndërtim është vlerësuar me 3.68 (ose 73.6%) nga një shkallë prej 1 (shumë dobët) në 5 (shumë mirë). INSTAT organizon çdo vit Anketën e Kënaqësisë së Përdoruesve.
12.3. Plotshmëria	Statistikat e IKN në mbështetje me rregulloren e Eurostat mbi këtë tregues, përbëhen nga dy tregues statistikorë: IKN - Banesa dhe IKN - Punime inxhinierike. Niveli i plotshmërisë të treguesve të prodhuar nga INSTAT është 50 %. Kjo përlllogaritje ka marrë në konsideratë raportin e numrit të treguesve të llogaritur nga INSTAT kundrejt numrit të treguesve që kërkohen nga rregullorja evropiane.
13. Saktësia dhe besueshmëria	
13.1. Saktësia e përgjithshme	Saktësia e përgjithshme e të dhënave të IKN (për banesa) konsiderohet të jetë e lartë veçanërisht në saktësinë metodologjike të burimit të peshave dhe çmimeve dhe llogaritjes në përputhje me Rregulloren Evropiane.
13.2. Gabim i kampionimit	Nuk është e aplikueshme për aktivitetin statistikor, pasi të dhënat e IKN (për banesa) janë të bazuara në kampione jo-probabilitare.
13.3. Gabim jo i kampionimit	Gabimet jo të kampionimit janë kryesisht gabime që ndodhin gjatë matjeve ose refuzimeve. Këto gabime vlerësohen dhe krahasohen me rezultatet e

	periudhave të mëparshme. Për të marrë informacionin korrekt dhe për të rritur normën e përgjigjeve, ndërmarrjet rikontaktohen me telefon ose drejtpërdrejt. Mos-përgjigja në nivel rekordi merr në konsideratë ndërmarrjet që nuk janë në gjendje apo të gatshme për të dhënë përgjigje, ose kur intervistuesit nuk janë në gjendje për të gjetur ndërmarrjet, ose kur ekzistojnë pengesa të tjera për të përfunduar intervistën. Shkalla e mos-përgjigjes në nivel rekordi për IKN 2020 është 12.0 %. Mbi-mbulimi ndodh kur ndërmarrja e zgjedhur është në një aktivitet të caktuar objekt i anketimit dhe gjatë procesit të intervistimit ajo nuk është më objekt i anketimit ose statusi i ndërmarrjes ka ndryshuar, nuk është më aktive. Shkalla e mbi-mbulimit për IKN 2020 është 2.4%.								
14. Afatet kohore dhe përpikmëria									
14.1. Afatet kohore	Rezultatet e Indeksi i Kushtimit në Ndërtim (për Banesat) janë publikuar në faqen e internetit të INSTAT 63 ditë pas përfundimit të periudhës referuese (T + 63 ditë). <table border="1"> <tr> <td>Periudha referuese</td><td>12/31/2020</td></tr> <tr> <td>Data e publikimit</td><td>3/4/2021</td></tr> <tr> <td>Afatet kohore</td><td>63</td></tr> </table>	Periudha referuese	12/31/2020	Data e publikimit	3/4/2021	Afatet kohore	63		
Periudha referuese	12/31/2020								
Data e publikimit	3/4/2021								
Afatet kohore	63								
14.2. Përpikmëria	Të dhënat e Indeksi i Kushtimit në Ndërtim (për Banesat) publikohen bazuar në kalendarin e publikimeve. Publikimi i Indeksi i Kushtimit në Ndërtim (për Banesat) ka qenë i përpiktë në kohë në 100 % të publikimeve të kryera gjatë viteve. <table border="1"> <tr> <td>Periudha referuese</td><td>12/31/2020</td></tr> <tr> <td>Data e shpallur</td><td>3/4/2021</td></tr> <tr> <td>Data e publikimit</td><td>3/4/2021</td></tr> <tr> <td>Vonesa në kohë</td><td>0</td></tr> </table>	Periudha referuese	12/31/2020	Data e shpallur	3/4/2021	Data e publikimit	3/4/2021	Vonesa në kohë	0
Periudha referuese	12/31/2020								
Data e shpallur	3/4/2021								
Data e publikimit	3/4/2021								
Vonesa në kohë	0								
15. Koherenca dhe Krahaseshmëria									
15.1. Krahaseshmëria gjeografike	Informacioni grumbullohet në nivel vendi. Indeksi llogaritet në nivel vendi.								
15.2. Krahaseshmëria kohore	Indeksi i Kushtimit në Ndërtim (për banesa) prodhohet me frekuencë tremujore, vjetore dhe rezultatet janë të krahasueshme. Seritë kohore janë të disponueshme që nga viti 1993 (me periudha bazë: 1993 = 100; Tr.4.1999 = 100 dhe aktualisht Tr.1.2011 = 100). Sidoqoftë, kur								

	krahasojmë indekset në periudha të ndryshme kohore duhet të kihet parasysh se matja e ecursisë së çmimeve nuk realizohet për ndërtesa të ngjashme të krahasueshme, por për lloje të ndryshme të ndërtesave të ndërtuara në periudha të ndryshme duke përdorur teknika të ndryshme, materiale të ndryshme dhe me kërkesa të ndryshme ligjore. Kjo do të thotë se jo vetëm struktura e peshave, por edhe metodat për grumbullimin e çmimeve dhe llogaritjen e indekseve janë të ndryshme. Për të mundësuar krahasimin duhet që indekset të llogariten me të njëjtën periudhë bazë.
15.3. Koherenca e ndërthurjes së fushave	Indekset nuk janë të krahasueshme me tregues të tjerë.
15.4. Koherenca e brendshme	Indekset janë të krahasueshme pjesërisht me Indeks të Çmimeve të Prodhimit dhe atë të Konsumit.
16. Kostoja dhe ngarkesa	Personat që punojnë për anketat e Çmimeve: IKN, IÇP, IÇI dhe IÇSh: Gjithsej: 73 punonjës • Stafi i përgjithshëm në zyrat qendrore: 3 punonjës • Intervistuesit 65 nga të cilët: 40 anketues afatgjatë dhe 25 afatshkurtër • Operatorët (4 muaj): 5 punonjës.
17. Rishikimi i të dhënave	
17.1. Politika e rishikimit	Politikat e rishikimit bëhen në përputhje me politikën e rishikimit si dhe politikën e trajtimit të gabimeve të vendosura nga INSTAT. E njëjta politikë rishikimi zbatohet për të dhënat në nivel kombëtar dhe ato të transmetuara në EUROSTAT. Për më shumë referohuni: • Politika e revizionimit • Politika e trajtimit të gabimeve.
17.2. Praktika e rishikimit	Të dhënat e publikuara nuk konsiderohen përfundimtare dhe mund të rishikohen. Indekset mund të rishikohen për disa arsye: Informacion shtesë, ndryshime metodologjike, ndryshimi i periudhës bazë, korrigjime të gabimeve ose ndryshime metodologjike, por rishikimet janë përgjithësisht mjaft të kufizuara në shkallë.
18. Përpunimi statistikor	
18.1. Burimi i të dhënave	Burimi i të dhënave për IKN (për banesa) janë: • Anketa e Kushtimit në Ndërtim për shpenzimet materiale; • Anketa tremujore e ndërmarrjeve (modulari 122) informacion për makineritë, transportin dhe shpenzimet e pagave; • Indeksi i Çmimeve të Prodhimit (shpenzimet e energjisë)

	IÇK (shpenzimet e tjera).
18.2. Shpeshtësia e grumbullimit të të dhënave	Të dhënat mbledhen çdo tremujor.
18.3. Grumbullimi i të dhënave	Grumbullimi i të dhënave realizohet nëpërmjet Anketës së Kushtimit në Ndërtim (për banesa). Mbledhja e rregullt e të dhënave të çmimeve normalisht rrjedh nga një kampion i njësive statistikore. Plotësimi i informacionit realizohet me intervistim të drejtpërdrejt nga anketuesit me personin e kontaktit të ndërmarrjes, i cili është ngarkuar për të deklaruar të dhënat.
18.4. Vlefshmëria e të dhënave	Verifikimi i çmimeve: çmimet e mbledhura krahasohen me trendin e tyre historik, ndryshimet e çmimeve për produkte të ngjashme dhe njohuri të tjera të fituara nga analistët; ndryshimet e konsiderueshme të çmimeve verifikohen me njësinë raportuese. Në INSTAT, çmimet kontrollohen në pyetësor, gjatë procesit të hedhjes së të dhënave dhe me telefon në rastet kur pyetësi nuk është plotësuar si duhet.
18.5. Përpilimi i të dhënave	Në nivel kombëtar Hapi i parë është mbledhja e informacionit nga intervistuesit. Qëllimi është sjellja e këtij informacioni në nivel statistikor. Ky proces vijon si më poshtë: - Kontrolli fizik i pyetësorëve - Kontrolli logjik i pyetësorëve (kontrollin e indikatorëve, përshkrimin dhe Kodifikimin e aktivitetit, dhe kontrollin e vlerave të sakta.) - Procesi i editimit të të dhënave të mbledhura (gabimet dhe modifikimet) - Njësitë që refuzojnë dhe informacioni që mungon duhet të plotësohet përmes procesit të imputimit. - Indekset e Laspeyres - Analiza e rezultateve sipas çdo domeni të publikimit.
18.6. Rregullimi	Nuk aplikohet. Të dhënat nuk janë të përshtatura sezonalisht.
19. Komente	
Aneks	